



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202201220/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë.

Drejtuar: **Z. Admir ABRIJA**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Engjëllush AVDYLAJ
Drejtor i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë

VLORË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020, datë 25.06.2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim periodik në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në Vlorë më datë 12.10.2022, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, z. Besnik Deda, znj. Gloria Çarkaxhiu, dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë, garantimi i të drejtave dhe trajtimi i të paraburgosurve në bazë të akteve ligjore e nënligjore dhe dokumenteve ndërkombëtare në fuqi, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Gjatë vizitës monitoruese, grupit të inspektimit ju ofrua mundësia që të kishin akses të plotë në këqyrjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar, inspektimin dhe evidentimin e kushteve ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit në këtë institucion, si dhe zhvillimin e intervistave konfidenciale me personat e paraburgosur, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve në fuqi.

Mekanizmi Kombëtar, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën e detyrimit kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Grupi i inspektimit bazuar në metodologjinë e inspektimit në burgje, zhvilloi paraprakisht një takim me drejtorin e institucionit z.Engjëllush Avdyraj dhe shefin e policisë z.Besim Binaj, të cilët u njohën me qëllimin e inspektimit.

Në takim, drejtuesi i institucionit informoi grupin e inspektimit për situatën e popullimit të të paraburgosurve në institucion, gjendjen e kushteve në të cilën ndodhen ambientet e dhomave dhe atyre të përbashkëta në regjimin e brendshëm ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit, masat e marra nga secili nga sektorët dhe shërbimi i sigurisë të institucionit për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të të paraburgosurve në këto ambiente, mënyrën e funksionimit të sistemit të trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ ankesave, gjendjen shëndetësore dhe psiko-sociale të të paraburgosurve, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Nisur nga infrastruktura e godinave në regjimin e brendshëm, elementët e sigurisë, cilësia e shërbimeve që ofrohen, si dhe ambientet e jashtme që shërbejnë për ajrim dhe aktivitete të përbashkëta, theksojmë se I EVP Vlorë garanton standarde të pranueshme për sa i përket kushteve infrastrukturore për të paraburgosurit.

Sipas informacionit, I EVP Vlorë, bazuar në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 "Për disa ndryshime në Urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë "*Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*", kategorizohet "institucion paraburgimi" i sigurisë së zakonshme.

Në ditën e inspektimit në I EVP Vlorë ishin të akomoduar 164 të paraburgosur, nga të cilët 4 persona ishin të moshës 18-21 vjeç, për të cilët nuk kishte dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këtë kategori, si dhe 4 persona të sëmurë me probleme të shëndetit mendor për të cilët nuk kishte Sektor të Kujdesjes së Veçantë (SKV). Kapaciteti zyrtar i institucionit ishte për 156 persona, pa përfshirë këtu ambientet e dhomave në sektorin e infermierisë, si dhe sektorin e observimit dhe veçimit, pasi kapaciteti arrin në një total prej 168 persona. Por duke qenë se dhoma e sektorit të observimit dhe veçimit apo infermeria, ato janë vëndqëndrim e të përkoshme dhe nuk llogariten në kapacitetin zyrtar institucional. Për rrjedhojë në **institucion ishin 8 persona të paraburgosur** mbi kapacitetin fizik dhe për pasojë kjo situatë mbipopullimin kishte ndikuar në përkeqësimin e kushteve të jetesës të të paraburgosurve, sidomos në dhomat e banimit ku ishin akomoduar 3 deri 4 persona. Kjo situatë e mbipopullimit, kishte cënuar parametrat e nevojshëm të hapësirës dhe sipërfaqes jetike për një person në dhomat e banimit. Shkelja e këtyre standardeve bazike për jetesë, përbën trajtim jo dinjitoz të personave që vuajnë dënimin në kushtet e këtij institucioni.

Gjithashtu, grupi i inspektimit kërkoi informacion për situatën e popullimit edhe për periudhën vjetore të inspektimit, e cila rezultoi si më poshtë vijon:

1. Muaji Maj 2022 **151** persona

2. Muaji Qeshor 2022	153 persona
3. Muaji Korrik 2022	148 persona
4. Muaji Gusht 2022	150 persona
5. Muaji Shtator 2022	159 persona
6. Muaji Tetor 2022	164 persona

Nga inspektimi u konstatua se, një pjesë e të paraburgosurve që ishin mbi kapacitet, ishin të pajisur me shtretër për fjetje dhe të vendosur në dhoma të destinuar për 2 dhe 3 persona, duke ngushtuar në këtë mënyrë hapësirat e dhomave ekzistuese.

Fenomeni i mbipopullimit është evident edhe në 2 mujorin e fundit të evidentuar sa më lart. Në vlerësimin tonë, nisur nga fakti se IEVP Vlorë është institucion paraburgimi, situata e mbipopullimit veç mungesës së kapaciteteve akomoduese është në varësi edhe të dinamikës së vendimeve që marrin Gjykatat e Shkallës së Parë dhe të Apelit në Vlorë dhe Tiranë. Ndaj, në kushte të tilla, është tepër e domosdoshme që DPB e cila bën planifikimin e kapaciteteve akomoduese për çdo IEVP, të kërkojë edhe shpërndarjen e të paraburgosurve në IEVP-të e tjera më të afërta me Prokuroritë dhe Gjykatat e Rrethit Gjyqësor, pasi të paraburgosurit që jetojnë në objektet e kësaj IEVP-je, janë në kushte trajtimi jo dinjitoz.

Theksojmë se Komiteti European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (CPT), gjatë vizitës së tyre në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018, ka rekomanduar për IEVP-të, se: “Edhe pse numri i përgjithshëm i të paraburgosurve është ulur krahasuar me vizitat e mëparshme, autoritetet shqiptare duhet të mbajnë në konsideratë mangësinë e përmbushjes së standardit minimal prej 4 m² të hapësirës për person, kur në to sistemohen më shumë persona (në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit që mund të ndodhet brenda dhomës). Ky shqetësim është adresuar edhe në rekomandimet tona të mëparshme, bazuar edhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve¹, standard i cili duhet të respektohet plotësisht në praktikë”².

Godinat në regjimin e brendshëm dhe infrastruktura e institucionit, garantonin sigurinë dhe kushtet e qëndrimit të të paraburgosurve, për kryerjen e veprimeve sipas orarit ditor, por dhe për të përballuar dinamikën e hyrjeve të reja dhe transferimit të të paraburgosurve në IEVP të tjera, situatë kjo që ndryshonte çdo ditë në varësi të vendimeve të gjykatave.

Organika e miratuar për IEVP në Vlorë përbëhej nga 135 punonjës, nga të cilët 26 ishin punonjës civil dhe 109 punonjës me uniformë të sektorit të shërbimit të sigurisë së institucionit. Në mungesë ishte vetëm vendi i zv. Drejtorit, 1 specialist në sektorin e Burimeve Njerëzore, 1 vend vakant në sektorin ligjor dhe 1 specialist financiar, në sektorin e financave dhe buxhetit. Ndërsa në sektorin e policisë ishte 1 vend vakant Komisar, dhe pjesa tjetër ishte plotësuar sipas organikës.

¹ Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Neni 30 parashikon se: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m² për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

² shih: <https://rm.coe.int/168097986b> “Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2019) fq. 32.

Nisur nga informacioni i Drejtorit të institucionit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm³ rezultoi se:

1. **Ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi**, për afishimin e numrave të telefonit të kontaktit me Avokatin e Popullit në vende të aksesueshme për të paraburgosurit.
2. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për marrjen e masave për parandalimin e virusit COVID-19, për furnizimin me detergjentë dhe pajisje higjeno-sanitare shtesë dhe sipas normativave mujore për të paraburgosurit, për mbajtjen e higjenës dhe pastërtisë personale, dhomave të banimit dhe ambienteve të përbashkëta, si dhe ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit, për verifikimin e furnizimit me detergjente sipas normativave mujore për të burgosurit, si dhe të marrjes së firmave të cilat të vërtetojnë marrjen në dorëzim të materialeve prej tyre.
3. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për përmirësimin e skemës së furnizimit dhe rimbursimit të ilaçeve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Vlorë sipas kontratës tre palëshe me ISKSH dhe depon farmaceutike, për të bërë atë efektive.
4. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për rritjen e kapaciteteve të kurseve profesionale, në shtimin e numrit të të paraburgosurve për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si dhe nxitjen e organizimit e aktiviteteve edukative e social-kulturore-sportive me të paraburgosurit, duke respektuar masat e parashikuara në protokollin shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në institucion.
5. **Ishte plotësuar rekomandimi**, për mobilimin me orenditë e nevojshme dhe pajisjen me materiale informuese, për të mundësuar realizimin e takimeve mes të paraburgosurve dhe fëmijëve të mitur të tyre në kuadrin e garantimit të prindërimit në distancë⁴.
6. **Ishte plotësuar pjesërisht rekomandimi**, për përmirësimin e cilësisë së ushqimit dhe larminë e tij sipas produkteve të stinës, si dhe ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit, për këtë problematikë.
7. **Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi**, për pajisjen me mjete të nevojshme, si: dyshek, por jo me tavolina, stola, komodina sipas kushteve normale për jetesë në dhomat observimit, me kushte higjeno-sanitare të pastra dhe dezinfektim të shpeshtë të këtyre ambienteve në IEVP Vlorë.

Ndërkohë, një pjesë e rekomandimeve të paraqitura nga Avokati i Popullit nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar. Më konkretisht:

1. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për hidroizolimimin e tarracës të godinës së banimit, për eliminimin e lagështirës në dhomat e të paraburgosurve dhe në ambientet e përbashkëta të dusheve dhe tualeteve.
2. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë të ambienteve në regjimin e brendshëm të institucionit, duke gjetur mënyra

³ Rekomandimi i dërguar me shkresën nr. K4/I68-2 prot., datë 17.12.2021.

⁴ Shkresë të përgjigjes së rekomandimit tonë me nr. 51 prot, datë 19.01.2021.

alternative të furnizimit me ujë ose duke shtuar orët e grafikut të lejimit të ujit për mbajtjen e higjienës personale të të paraburgosurve, pastërtinë e dhomave të banimit e ambienteve të përbashkëta, si dhe për furnizimin me ujë të pijshëm.

3. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për eliminimin e mbipopullimit në I EVP Vlorë, pasi kjo situatë ka sjellë për pasojë shkeljen e të drejtave jetike të personave të paraburgosur që vuajnë dënimin në këtë institucion, si dhe përbën shkelje të standardeve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.
4. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për instalimin në godinën e të paraburgosurve të sistemit qendror për ngrohje/ftohjen e ambienteve të brendshme të institucionit, si dhe garantimin në çdo kohë të furnizimit me ujë të ngrohtë për mbajtjen e higjienës personale të të paraburgosurve dhe të ambienteve të përbashkëta, në përshtatje dhe me kushtet klimaterike të zonës.
5. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për vënien në funksion të të gjitha dusheve, si dhe lyrjen e ambienteve për të qenë sa më të pastra nga ana higjieno-sanitare.
6. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këtë kategori.
7. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e Sektorit të Kujdesit të Veçantë (SKV) në I EVP Vlorë.
8. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për plotësimin sipas strukturës organike të sektorit shëndetësor të institucionit me 1 mjek të përgjithshëm dhe 1 stomatolog, me kohë të plotë me qëllim garantimin cilësor të shërbimit shëndetësor për të burgosurit pacientë kronikë dhe të burgosurit e tjerë.
9. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për plotësimin e palestrës me materiale, si gira, shtanga sipas peshës dhe vegla të tjera, që ndihmojnë të paraburgosurit të kalojnë kohë shlodhëse në këtë drejtim.
10. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për transportin e të sëmurëve në rastet e emergjencave shëndetësore.

Është rasti të theksojmë se garantimi i kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerezor, poshtërues apo degradues, si dhe rekomandimet e CPT-së dhe të Avokatit të Popullit duhen vlerësuar maksimalisht nga institucionet që ato ju drejtohen. Këto rekomandime nuk ju drejtohen personave të caktuar personalisht, por institucioneve të administratës publike dhe drejtuesve të tyre me cilësinë e titullarit. Ne vlerësojmë se nuk është qëndrim aspak serioz, zbatimi i rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit dhe më parë CPT, pasi pavarësisht ndryshimit të vazhdueshëm të titullarëve të institucioneve, ata kanë detyrimin ligjor në zbatim neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Për sipër, grupi inspektimit u informuar nga drejtuesi i IEVP Vlorë, se ky institucion i është drejtuar në mënyrë të vazhdueshme Drejtorisë Përgjithshme të Burgjeve për mbështetje financiare për përmirësimin e kushteve në këtë institucion.

Inspektimi i MKPT-së në IEVP Vlorë, u krye pa paralajmërim dhe pa mbikëqyrjen e stafit të institucionit gjatë zhvillimit të intervistave konfidenciale me të burgosurit, si dhe u zhvillua në përputhje me procedurat e parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Trajtimi i të paraburgosurve

Objekti i vizitës inspektuese të grupit të monitorimit, ishte trajtimi i të paraburgosurve, identifikimi i rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar në aktet normative, apo presionit psikologjik ndaj tyre, si dhe përdorimi efektiv i masave disiplinore në bazë të kushteve dhe kritereve të përcaktuara në aktet ligjore kombëtare dhe aktet ndërkombëtare të fushës.

Nga informacioni që u grumbullua gjatë vizitës inspektuese dhe intervistimi i të paraburgosurve, grupi monitorues nuk konstatoi raste apo pretendime nga të paraburgosurit, lidhur me keqtrajtim apo tejkalim të forcës fizike nga ana e punonjësve të shërbimit të sigurisë apo e stafit të institucionit.

Grupi i inspektimit, një vëmendje të veçantë i kushtoi këqyrjes së procedurave që ndiqen nga stafi i institucionit për trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të të burgosurve nga administrata e institucionit, funksionimit të komisionit të pritjes në lidhje me trajtimin e të burgosurve që hyjnë rishtaz në institucion, funksionimin e komisionit për dhënien e masave disiplinore, cilësisë së aktiviteteve që zhvillohen me të burgosurit, ofrimit të shërbimit dhe trajtimit shëndetësor të të burgosurve, cilësisë dhe larmishmërisë së ushqimit, furnizimit të të burgosurve sipas normativave mujore me detergjente dhe mjete të higjienës personale, etj.

Grupi i inspektimit, inspektoi edhe plotësimin e kushteve materiale të jetesës për të paraburgosurit në këtë institucion. Inspektimi u përqëndrua kryesisht tek kushtet e banimit, mbipopullimi në dhoma, higjiena personale, kushtet sanitare, veshjet, cilësia e përgatitjes dhe shpërndarjes në kohë të ushqimit, ndriçimi, ventilimi, ngrohja, ambientet e takimit me familjarët, komunikimi telefonik dhe monitorimi me kamera i ambienteve të përcaktuara sipas skemës së sigurisë.

Theksojmë se, infrastruktura në regjimin e brendshëm të institucionit ishte e plotë dhe funksionale, e cila mundësonte jetesë normale dhe llojshmëri të zhvillimit të aktiviteteve me të burgosurit. Godinat, dhomat e banimit dhe ambientet e përbashkëta në regjimin e brendshëm, ishin në gjendje të mirë teknike.

Në godinën e IEVP-së ishte **evidente lagështira, më e theksuar në ambientin e tualeteve në këtë institucion.** Niveli i lagështirës ishte tej normave të lejuara dhe për pasojë prezenca e saj në këto ambiente, ndikon drejtëpërdrejt në jetën dhe shëndetin e të paraburgosurve, si dhe për vetë punonjësit e policisë së burgut.

Personat e moshës 18-21 vjeç **nuk** ishin të akomoduar në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këta persona, por ata ishin të shpërndarë në dhoma

me të paraburgosurit. Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, sistemimi i tyre në dhoma të veçanta, ishte i pamundur për shkak të mospërshtatjes dhe familjarizimit që ata kishin me të paraburgosurit e tjerë. Ajrimi dhe veprimtaritë me karakter sportiv dhe edukativ, për shkak të situatës së pandemisë, vijonin të zhvilloheshin me grupe të vogla dhe të ndarë sipas grup moshave dhe interesave të të paraburgosurve.

Nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me të paraburgosurit, rezultoi se kishte disa ankesa që ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion. Ato konsistojnë në përqendrimin e kushteve të jetesës në disa dhoma banimi, për shkak të mbipopullimit të tyre mbi kapacitetin fizik; në prezencën e lagështirës në disa dhoma banimi dhe kryesisht në ambientet e përbashkëta si në tualete dhe dushe; problemet me sistemin elektrik; mungesën e ujit të ngrahët për larjen e trupit, etj.

Grupi i inspektimit, mori ankesa nga të burgosurit edhe për mosfunksionimin e sistemeve (chiller, kaldajë), që shërben për ngrohjen/ftohjen e ambienteve në regjimin e brendshëm. Ky shqetësim bëhej serioz gjatë stinës së dimrit kur temperaturat në këtë zonë ishin të ulta deri nën zero. Institucioni për periudhën e dimrit kishte lejuar futjen në regjimin e brendshëm të ngrohëseve elektrike, ndërsa në verë të pajisjeve elektrike për ftohje, të cilat veç funksionit të tyre, kishin rritur ngarkesat në rrjetin elektrik dhe dëmtonin sistemin e brendshëm elektrik.

Gjithashtu, një problematikë që u evidentua gjatë intervistave me të paraburgosurit, kishte të bënte me mungesën e furnizimit rregullisht, sipas normativave mujore, me produkte të higjienës personale si sapun, letër higjienike dhe të pajisjeve për pastrimin e dhomave, si dhe me detergjentë. Avokati i Popullit kërkon shtimin e sasive të produkteve.

Në intervistat me të paraburgosurit, u ngrit si shqetësim mungesa në organikë e një mjeku me kohë të plotë, për shkak të nevojës që ata kishin për kryerjen në kohë të vizitave mjekësore apo lëshimit të rekomandimeve për vizita mjekësore pranë mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Vlorë. Mjeku që kryente detyrën në këtë institucion, nuk ishte me kohë të plotë, por ishte i punësuar me kontratë me kohë të pjesshme dhe koha për të kryer vizita mjekësore nuk ishte e mjaftueshme, pasi numri i kërkesave të të paraburgosurve për vizita mjekësore ishte i lartë. Kjo situatë, kishte kufizuar të drejtën e të paraburgosurve për të marrë shërbim shëndetësor më të specializuar pranë spitaleve apo klinikave mjekësore, që ndodhen në qytetin e Vlorës. Në rastin kur nuk është e mundur punësimi i një mjeku me kohë të plotë, IEVP-ja duhet të punësojë dy mjekë me kohë të pjesshme për të adresuar nevojat e të paraburgosurve.

Njëkohësisht, disa të paraburgosur të cilët kishin kryer analiza mjekësore në spitalin e Vlorës, ngritën me shqetësim se nuk kishin marrë asnjë përgjigje në lidhje me rezultatin e analizave, pavarësisht se kishin kaluar 15 ditë në raste të veçanta.

Kjo situatë, në vlerësimin e MKPT-së, kufizon të drejtën themelore të të paraburgosurve për të marrë shërbim shëndetësor në kohë sa më të shpejtë, si dhe për të marrë shërbim shëndetësor cilësor pranë spitaleve apo klinikave mjekësore, që ndodhen në qytetin e Vlorës.

Një problematikë që u evidentua nga intervistat me të paraburgosurit, kishte të bënte edhe me zvarritjet në zbardhjen e vendimeve nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe ekzekutimin në kohë të tyre nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga verifikimi i disa ankesave të të

burgosurve, rezultoi se zvarritja e vendimeve shkonte deri në 6 muaj. Ky konstatim ka të bëjë me procedurat gjyqësore dhe të prokurorisë, por edhe administrata e IEVP-së duhet të bashkëpunojë më shumë dhe të jetë proaktive me administratat respektive, pasi është e pajustificuar një zvarritje kaq e gjatë e zbardhjes së vendimeve gjyqësore.

Të paraburgosurit, në intervistat me grupin e inspektimit, parashtruan nevojën e kontakteve më të shpeshta me juristin dhe punonjësit e stafit psiko-social, në lidhje me përditësimin e informacionit për ecurinë dhe zgjidhjen e ankesave drejtuar drejtorit të institucionit, si dhe për dhënien e ndihmës juridike për çështje që lidhen me veprën penale të kryer nga ana e tyre.

Në IEVP Vlorë ishin të punësuar 13 të paraburgosur, siç ishte përcaktuar sipas strukturës organike, në pozicione pune si sanitarë, ndihmës kuzhiner, shpërndarës ushqimi, berber, mirëmbajtjes, etj. Sipas intervistave me të paraburgosurit, punësimi paraqet interes për sa kohë që kushtet e punësimit dhe shpërblimi janë të rregulluar me aktet nënligjore, sikurse parashikohet në nenet 43 dhe 44 të ligjit nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*; të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr. 209, datë 06.04.2022; VKM-në nr.602, datë 13.10.2021 *“Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”*; të urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr. 169, datë 16.05.2022 *“Për lidhjen e kontratës së punës me të burgosurit e punësuar për nevoja shërbimi në IEVP dhe pagesat e tyre”*. Avokati i Popullit vlerëson se pavarësisht moslidhjes së kontratës me shkrim, detyrimi i pagës ka lindur me miratimin e VKM-së dhe drejtuesi i burgut duhet të kalojë fondet në masën 40% tek këta persona.

Masat mbrojtëse

Në intervistat e zhvilluara me të paraburgosurit dhe stafin e institucionit, u kërkua informacion për sistemin e kërkesë/ankesave, ku rezultoi se ai funksiononte sipas urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve⁵. Në urdhër, përcaktohen personat përgjegjës të autorizuar të cilët në mënyrë periodike marrin kërkesë/ankesat e të paraburgosurve, kryejnë regjistrimin në regjistrin përkatës, protokollimin e tyre, si dhe trajtimin dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit të përcaktuar nga titullari i institucionit⁶. Ky regjistër, ruhet dhe administrohet nga sekretaria e institucionit.

Të paraburgosurit, pasi plotësonin një formular kërkesë/ankese ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social, sipas sektorëve që mbulonin. Më tej, punonjësi i edukimit, kërkesë/ankesat e të burgosurve brenda ditës i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili nëpërmjet sektorëve përgjegjës, kthente përgjigje në kohë sa më të shpejtë.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, për vitin 2022 ishin regjistruar nga të paraburgosurit, të cilat kishin për objekt kërkesa për blerje TV, biseda në SKYPE me familjen, aplikim për hapje llogarie në bankë, kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku, dërgimin te mjekët specialist në Spitalin Rajonal Vlorë, pajisjen me kopje të vendimit të gjykatave, konsulenca juridike, etj.

⁵Neni 58, pika 5 e ligjit Nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

⁶Neni 58 i ligjit Nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

Grupi i inspektimit nuk mori ankesa në lidhje me procedurat që ndiqen nga stafi i institucionit në lidhje me trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesave të tyre nga drejtuesit e institucionit. Ata ngrinin problemin e vonesave në përgjigje të kërkesave të tyre nga DPB, kryesisht për ato kërkesa që kishin të bënin me transferimin në IEVP-të e tjera.

Gjatë inspektimit, u verifikuan gjithashtu procedurat e ndjekura për hyrjet e reja të të paraburgosurve në institucion, ngritja dhe funksionimi i komisionit të pritjes, intervistimi i të paraburgosurve, evidentimi i gjendjes shëndetësore dhe psiko-sociale të tyre, si dhe mënyra e plotësimit të regjistrit dhe dosjeve personale të të paraburgosurve. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni u konstatua se, procedura e pranimit të të burgosurve që hyjnë rishtaz në institucion zbatohet në mënyrë korrekte nga komisioni i pritjes, praktikë kjo e cila ishte e evidentuar në libër dhe në regjistrin përkatës. Më tej, dokumentacioni protokollohej në sekretarinë e institucionit.

Sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi ishte funksional. Ato monitoronin ambientet në regjimin e brendshëm, si dhe mjediset e jashtme të institucionit përgjatë 24 orëve. Të dhënat nga regjistrimet e kamerave ruhen në server për një periudhë 30 ditore.

Theksojmë se mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjediseve të IEVP-së Vlorë, përveç mjediseve ku çenohet privatësia, është vlerësuar nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, si një masë mbrojtëse ndaj personave të privuar nga liria për tre arsye:

Së pari, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjeshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve.

Së dyti, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të burgjeve dhe paraburgimeve, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Komunikimi me telefon me familjet e tyre, të paraburgosurit i zhvillonin normalisht në telefonat me kartë të vendosur në mjediset e korridoreve në regjimin e brendshëm. Ata ishin në gjendje pune dhe të burgosurit kryenin 8 telefonata në muaj me familjet dhe të afërmit e tyre, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, nëpërmjet telefonave me kartë të vendosur në mjediset e korridoreve në regjimin e brendshëm.

Në lidhje me telefonatat, të paraburgosurit paraqitën ankesa në lidhje me shtimin e operatorëve të tjerë me telekartë, pasi monopoli i këtij shërbimi në sistemin e burgjeve, ka sjellë për pasojë rritjen e çmimit të kartave telefonike dhe uljen e minutave të bisedave telefonike. Ky shqetësim është ngritur nga të burgosurit edhe në IEVP-të e tjera.

Gjithashtu, grupi i inspektimit mori ankesa nga të burgosurit dhe bëri verifikimet përkatëse, në lidhje me komunikimin me telefon me Institucionin e Avokatit të Popullit. Të burgosurit deklarorin se, nuk mund të lidhen me numrat e telefonit të Avokatit të

Popullit të vëna në dispozicion të tyre, në çdo kohë dhe pa pagesë, pasi kompania që ofronte këtë shërbim nuk kishte bërë regjistrimin e numrave.

Sjellim në vëmendje të DPB-së, se këto problematika janë konstatuar nga grupet e MKPT-së edhe në IEVP-të e tjera, për të cilat është rekomanduar shtimi i operatorëve telefonik në sistemin e burgjeve, si dhe heqja e kufizimeve për të komunikuar me numrat e kontaktit të Avokatit të Popullit, por, sikurse konstatohet edhe nga inspektimi në këtë IEVP, këto rekomandime ende nuk kanë gjetur zbatim. Avokati i Popullit shpreh shqetësim të thellë për mosvlerësimin me kujdesin e duhur të rekomandimeve në lidhje me plotësimin e këtij detyrimi ligjor nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Ambienti i takimeve të të burgosurve me familjarët në IEVP Vlorë, kishte 1 post për takime online, 4 poste për takime fizike me familjarët e të paraburgosurve, 1 dhomë prindërimi në distancë dhe 1 dhomë për takime speciale me familjarët. Nga intervistat, rezultoi se të paraburgosurit zhvillonin 3 takime fizike dhe 1 takim online me familjarët e tyre për të cilat nuk kishin ankesa në lidhje me planifikimin dhe kohëzgjatjen e orarit të takimeve⁷.

Dhoma e prindërimit në distancë, ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige, ku të paraburgosurit mundet të takonin fizikisht fëmijët e tyre. Gjatë takimeve me fëmijët dhe familjarët në këto dhomë, respektoheshin masat e sigurisë, por dhe privatësia e takimit.

Kushtet materiale

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë është një institucion i ri, me infrastrukturë të plotë e funksionale në regjimin e jashtëm dhe të brendshëm të tij, sipas të gjitha standardeve të përcaktuara në dispozitat ligjore, nënligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Kushtet materiale të institucionit në funksion të të paraburgosurve, ishin të plotësuara dhe garantonin standarde përgjithësisht të pranueshme për jetesë normale dhe zhvillimin e aktiviteteve me karakter kulturor, edukativ dhe sportiv, për rehabilitimin e kësaj kategorie, me përjashtim të disa çështjeve të trajtuara më lart për sistemin ngrohje-ftohje, lagështirës etj.

Gjendja e godinave, ambientet e ajrimit, ambientet e përbashkëta dhe parametrat teknik të ndërtimit të dhomave të banimit, ishin në gjendje të mirë dhe plotësonin kërkesat e të paraburgosurve. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë, përbëhej nga dy godina A dhe D, secila nga tre kate, me 43 dhoma në total. Nisur nga infrastruktura e brendshme, në katin e parë ndodhen ambientet e përbashkëta për takime me familjarët, kuzhina, lavanderia, dushet e përbashkëta për të paraburgosurit. Ndërsa në katin e dytë ndodheshin salla e tv, palestra, biblioteka, ambientet e kultit fetar, klasat e kurseve profesionale, etj.

Ambientet në çdo sektor në regjimin e brendshëm, ishin sipas standardeve përsa i përket llojshmërisë së aktiviteteve ditore, si klasa edukimi dhe këshillimi psiko-social, dhoma

⁷ Aktualisht takimet me familjarët në të gjitha burgjet e vendit zhvillohen 4 herë në muaj, ku nga këto 3 takime fizike dhe 1 takim online, në bazë të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr.209, date 06.04.2022.

për takimet me familjarët, dhoma e prindërimit në distancë, klasa ku zhvillohet mësimi dhe për zhvillimin e kurseve profesionale, biblioteka, si dhe ambiente kulti të ndara më vete për besimtarët mysliman dhe katolik. Veç këtyre ambienteve, grupi i inspektimit konstatoi dhe disa ambiente (dhoma) të tjera, të cilat ishin të mbyllura dhe pa funksione. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, ato ambiente janë të ndërtuara që nga zbatimi i projektit, por nuk përdoren pasi nëse ato vihen në funksion, kërkojnë stafe mbështetëse dhe staf sigurie shtesë nga struktura organike e miratuar.

Dhomat e banimit në secilin sektor ishin të ndara në dhoma dyshe, treshe dhe dhoma katërshe, me parametra të tillë që mundësonin akomodimin e të burgosurve për jetesë, por hapësira dhe sipërfaqja e dhomave nuk ishte sipas normave të lejueshme (kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të burgosur)⁸, ndërkohë që dritaret lejonin ajrim dhe dritë të plotë natyrale.

Në dhomat e banimit akomodohen 2, 3 dhe 4 persona. Kushtet e dhomave, sipërfaqet dhe hapësirat ishin të përshtatura duke mos respektuar hapësirën jetike për person. Pothuajse të gjitha dhomat kishin tualete brenda, me kushte të mira higjieno-sanitare. Dhomat **nuk** ishin të pajisura me orenditë e nevojshme për mbajtjen e sendeve personale dhe ruajtjen e ushqimit të të paraburgosurve, por sikurse rezultoi në shumicën e rasteve këto orendi e pajisje ishin siguruar nga familjarët e tyre, për mbajtjen e ushqimit në kushte normale dhe të përshtatshme. Materialet për fjetje si dyshekët, batanijet dhe çarçafët ishin në gjendje të mirë dhe të mirëmbajtura.

Ambienti i dusheve ishte i përbashkët në katin e parë të institucionit. Dushet nuk ishin funksionale, pasi atyre u mungonin kokat e dusheve, si dhe kishin nevojë për lyrje dhe për t'u mbajtur pastër nga ana higjieno-sanitare. Të paraburgosurit laheshin në dhomat e tyre. Ky rekomandim është i përsëritur dhe institucioni duhet të parashikojë fonde për mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre.

Gjithashtu, institucioni kishte ambiente ajrimi, por ishin të pambuluara në rastet e kryerjes së ajrimit në mot me shi.

Ambientet në regjimin e brendshëm kishin energji elektrike të pandërprerë që furnizohej nga rrjeti elektrik, por kishte dhe burim energjie rezervë me gjeneratorë, për furnizimin me energji elektrike në rast ndërprerje.

Çdo sektor kishte telefona me kartë që të paraburgosurit mund të komunikonin me familjet e tyre, si dhe kuti postare për hedhjen e kërkesë/ankesave, të cilat hapeshin nga personeli i autorizuar i institucionit për këtë qëllim.

Furnizimi me ujë kryhej nga rrjeti i ujësjellësit në Drejtorinë Rajonale Vlorë, përmes një linje të dedikuar për këtë institucion. Ambientet në regjimin e brendshëm furnizoheshin me ujë sipas orareve të miratuara nga titullari i institucionit 3 herë në ditë. Grupi i inspektimit të MKPT-së, vlerëson se koha e furnizimit rregullisht me ujë që përdorej për mbajtjen e higjienës personale, për larjen e trupit dhe pastërtinë në ambientet e përbashkëta nuk ishte e mjaftueshme, pasi orari i furnizimit ishte i reduktuar dhe nuk arrinte të plotësonte nevojat e tyre. Përsa i takonte sigurimit të ujit të pijshëm, të paraburgosurit

⁸ Neni 33/4 i ligjit 81/2020 "Për trajtimin e të drejtave të dënuarve me burg dhe të paraburgosurve".

deklaroronin se atë e blinin kundrejt pagesës në njësinë e re tregtare, gjë e cila rriste shpenzimet e familjarëve të tyre.

Grupi monitorues inspektoi situatën e trajtimit, kushteve materiale dhe higjienike të të paraburgosurve në ambientet e observim/veçimit. Ky ambient përbëhej nga 2 dhoma observimi dhe 2 dhoma veçimi. Në ditën e inspektimit ambienti i observimit ishte pajisur me një krevat, dyshek, batanie, si dhe çarçafë. Gjithashtu, kishte 4 persona në dhomat observim/veçimit. Ambienti në tërësi ishte i pastër nga ana higjiene-sanitare, por kishte nevojë për lyrje. Problematikë në këto ambiente ishte gjithashtu dhe mungesa e dushit për larjen e trupit të personave, pasi në mungesë të tij, larja e trupit duhet të bëhej në ambientet e dusheve të përbashkëta sipas sektorëve.

Ushqimi për të paraburgosurit gatuhej në kuzhinën e institucionit, e cila ishte me hapësirë e sipërfaqe të madhe, si dhe me ambiente më vete për gatimin e ushqimit dhe për ruajtjen e tij. Kuzhina ishte e kompletuar me pajisje frigoriferike për secilin produkt ushqimor më vete, me pajisje kuzhine alternative (elektrike dhe gaz) për gatimin e vakteve ushqimore, si dhe me karroca për shpërndarjen e ushqimit deri te të paraburgosurit.

Në kuzhinë ndodhej e afishuar kuota ditore, menuja, si dhe librezat shëndetësore të personelit të kuzhinës, ndërsa gatimi i ushqimit kryhej sipas kategorive të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Burgjeve më vete për të burgosurit, për të punësuarit, si dhe për të sëmurët diabetik.

Personeli i kuzhinës përbëhej nga 4 kuzhinerë sipas strukturës organike dhe 6 ndihmës kuzhinerë, të punësuar nga radhët e të paraburgosurve. Në intervistat me të paraburgosurit, nuk u paraqitën ankesa lidhur me cilësinë e gatimit, larmishmërinë dhe shpërndarjen e ushqimit.

Një nga shqetësimet e ngritura në intervistat me të paraburgosurit, kishte të bënte me larjen e rrobave personale të të paraburgosurve në ambientin e dhomës. Ndërkohë, tharja e rrobave, në mungesë të një ambienti më vete, vazhdonte të kryhej brenda dhomave të banimit, duke përdorur mjete të tilla si kordona apo litarë për varjen dhe tharjen e tyre. Mbajtja e kordoneve apo litarëve në dhomat e banimit përbën rrezik për jetën, kryesisht të atyre personave që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, por edhe për sigurinë e të paraburgosurve të tjerë. Për këtë arsye Avokati i Popullit thekson se ambientet e lavanterisë duhet të jenë plotësisht funksionale për të mos pasur nevojë për marrje e teshave në dhomë, e cila mund të sjellë pasoja dhe rrezikshmëri për jetën e të paraburgosurveve.

Regjimi dhe aktivitetet

Regjimi dhe aktiviteti i të paraburgosurve, ishte i përcaktuar në orarin e veprimeve ditore të miratuar nga titullari i këtij institucioni. Orari i veprimtarive ishte i miratuar nga drejtori i institucionit dhe i unifikuar për të gjithë sektorët, pavarësisht sigurisë së të paraburgosurve dhe aktiviteteve që zhvilloheshin sipas grup moshave dhe kategorive, më vete për ata.

Gjatë inspektimit u vu re se zhvilloheshin aktivitete të përbashkëta nga të cilat mund të përfitonin të paraburgosurit, të cilat ishin kryesisht, lojërat e tavolinës siç janë lojërat me letra, domino, aktivitetet fetare, kalçeto, trajtimi periodik i temave sociale nga specialistët

e edukimit në sektorin përkatës, etj. Temat sociale janë realizuar në klasat e këshillimit duke krijuar fokus grupe me kategori të ndryshme me të paraburgosur dhe të dënuar, për ti ardhur në ndihmë rehabilitimit sa më shpejt në kushtet e privimit nga liria. Në ambientet e regjimit të brendshëm nga sektori i edukimit realizohet plani ditor i aktiviteteve ku realizohen aktivitete sportive, si futbollit në kalçeto dhe palestra. Në ambientet e palestrës sipas planit të aktivitetit ditor të dënuarit zhvillojnë palestër një orë në ditë për çdo kat sipas sektorëve përkatës. Në lidhje me këtë të paraburgosurit ngritën si shqetësim mungesën e materialeve në palestër si psh. gira në çdo rast, shtaga të ndryshme sipas peshave, shtrimin me tapet, etj.

Nga ana dokumentare, sektori i çështjeve shoqërore kishte të hartuar programe mujore pune, programe për trajtimet individuale psiko-sociale, si dhe plane mujore të aktiviteteve. Në rastin e festave kombëtare dhe festave fetare, në bashkëpunim me sektorin e policisë, ishin organizuar aktivitete të veçanta. Për secilin të paraburgosur ishin të plotësuar dosjet psiko-sociale.

Gjithashtu, në I EVP Vlorë prej muajit shtator ka rifilluar zhvillimi i procesit arsimor, ku pjesë e këtij procesi janë të paraburgosurit të cilët nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar. Procesi arsimor në kushtet e kufizimit të jetës së lirë realizohet nga 3 (tre mësuese), të cilat përkatësisht japin lëndët shkencore, shoqërore dhe ciklin e ulët.

Në I EVP Vlorë, në mënyrë të vazhdueshme janë zhvilluar kurset profesionale për elektrikist dhe për gjuhën angleze. Në këto kurse marrin pjesë të paraburgosur të cilët i frekuentojnë rregullisht dhe në përfundim të kursit pajisen me certifikatë pjesëmarrje. Aktualisht këto kurse zhvillohen çdo ditë sipas programit të përcaktuar dhe kishte nga 10 të paraburgosur për secilin kurs.

Është për t'u theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin që do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*⁹.

Mekanizmi Kombëtar thekson nevojën e vazhdueshme të ndërthurjes së aktiviteteve kulturore-sportive dhe edukative me të paraburgosurit sipas grup moshave dhe kategorive, si dhe hartimin e programeve për këshillimin dhe trajtimin individual të këtyre personave, me qëllim që ata të kenë mundësi të ndërveprojnë me njëri-tjetrin, si dhe të mbushin sado pak atë boshllëk psikologjik dhe edukativ, që krijohet tek këta persona nga mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive me botën jashtë, gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit.

Shërbimi shëndetësor

Grupi i inspektimit, gjatë vizitës inspektuese në I EVP Vlorë, i kushtoi një rëndësi të veçantë funksionimit dhe cilësisë së ofrimit të shërbimit shëndetësor të të paraburgosurve, për garantimin dhe ruajtjen e shëndetit të këtyre personave që vuajnë dënimin në regjimin e burgjeve, si dhe krahasuar me standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

⁹Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://ëëë.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

Sipas strukturës organike të re të institucionit, personeli mjekësor përbëhej nga 8 punonjës, nga të cilët 1(një) mjek i përgjithshëm me kohë të pjesshme, 1(një) stomatolog me kohë të pjesshme 1(një) farmacist dhe 5 (pesë) infermierë.

Koha në dispozicion për kryerjen e vizitave mjekësore nga mjeku, ishte në varësi të numrit të kërkesave dhe diagnozës që paraqisnin të paraburgosurit, të cilat varionin brenda ditës ose maksimumi brenda 2 ditëve. Vizitat mjekësore pranë mjekëve specialistë në Spitalin Rajonal të Vlorë, me rekomandimin e mjekut të institucionit, kryheshin në varësi të masave së sigurisë për lëvizjen e të sëmurëve nga IEVP Vlorë për në spital, mundësisht menjëherë për rastet urgjente, ndërsa për të sëmurët kronikë koha e pritjes shkonte deri në 10 ditë.

Në IEVP Vlorë kishte 27 të sëmurë kronik, si dhe 6 persona të sëmurë të shëndetit mendor dhe 6 paraburgosur si përdorues droge (që marrin trajtim me metadon) të cilët trajtoheshin me medikamente, ushqim dhe vizita mjekësore sipas rekomandimeve të mjekëve specialist.

Shërbimi shëndetësor ndodhej në katin e dytë të godinës në regjimin e brendshëm, në një ambient të veçantë ku ndodhej dhoma e vizitave të mjekut, dhoma e stomatologut, farmacia dhe dhoma për konsultat ditore dhe rastet e urgjencës.

Dhomat e vizitave ishin të plotësuara me krevat dhe shtrroje, në kushte të mira higjieno-sanitare. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me autoklavë dhe poltron të ri dhe funksiononte rregullisht për ofrimin e shërbimeve të nevojshme.

Dhoma shtrimi ishin 5(pesë), të pajisura 3 (tre) dhoma me 1 (një) shtrat, dhe 2 (dy) dhoma të tjera me 2 (dy) shtretër. Dhomat spitalore ishin të pajisura me dyshek, batanie, çarçafë, por mungonin pajisjet e domosdoshme për të përmbushur nevojat kryesore të jetesës, si tavolina, stola, komodina. Gjithashtu, për larjen e trupit kishte ambiente të posaçme në fund të korridorit, (2 dushe me ujë të ngrohtë), si dhe 2 tualete të përbashkëta, të cilat ishin funksionale për këtë qëllim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti ai i mjekut, u konstatua se, nga ana e tij ishin siguruar konsultime të vazhdueshme me të paraburgosurit. Sa i përket regjistrave, dhe konkretisht ai i vizitave mjekësore, mjekimeve, konsultave të specializuara në Spitalin Rajonal të Vlorës, i të sëmurëve mendorë dhe i abuzuesve me substanca narkotike/ alkoolit, i personave që refuzojnë terapinë, si dhe regjistri i informacionit 24 orësh të infermiereve, ata u gjetën të gjithë të sekretuar dhe të mbajtur më rregull. Kartelat mjekësore ishin të mbajtura në rregull dhe të mbyllura në dollap me çelës.

Ndërkohë konstatuam se nga ana e stafit mjekësor ishin marrë masat për pajisjen e sektorit të shëndetësisë me një libër për regjistrimin e rasteve të veçanta dhe të dhunës. Skema e rimbursimit të ilaçeve në parim ishte në rregull dhe të paraburgosurit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Skema e rimbursimit të ilaçeve funksiononte mirë për të paraburgosurit, sipas kontratës trepalëshe me FSDKSH dhe depon farmaceutike. Ndërkohë, që më i vështirë bëhej zbatimi i kësaj skeme për të paraburgosurit, të cilët për shkak të vonesave në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve personale e kishin më të vështirë sigurimin e ilaçeve me anë të skemës së rimbursimit të ilaçeve. Gjithashtu, nga

të intervistuarit u ngritën ankesa në lidhje me mungesën e medikamenteve në institucion, të cilat shpesh mbuloheshin me kontributet e tyre nga familjarët.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Vlorë, nuk kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë, në një kohë që për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjienës vetjake të tyre, si dhe të mjedisit që i rrethon.

Personat të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, për shkak të sëmundjes së tyre, kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, veçanërisht nga ekipi multidisiplinar i institucionit, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 3 të ligjit 44/2012 “Për Shëndetin mendor”, ku thuhet se: "Ekipet multidisiplinare" janë ekipet e përbëra nga specialistë të disa fushave, si mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, terapistë okupacionalë, logopedistë, terapistë zhvillimi apo specialistë të tjerë, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor¹⁰.

Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson kushtet infrastrukturore të krijuara për ofrimin e shërbimit shëndetësor të të burgosurve, por thekson se, mungesa e mjekut me kohë të plotë dhe mosfunksionimi i këtij shërbimi për t’iu përgjigjur në kohë kërkesave dhe nevoja të të sëmurëve në këtë institucion, shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje deri te mjeku nga ana e personave të paraburgosur, si dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe mbulimin e shërbimit shëndetësor dhe për këtë arsye duhen marrë masa të menjëhershme për plotësimin e stafit, pasi mund të ketë raste urgjente të cilat personeli shëndetësor nuk mund t’i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda.

Lidhur me këtë konstatim, KPT (CPT) në rolin e monitoruesit ndërkombëtarë të respektimit të drejtave të të burgosurve, ka rekomanduar se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”.*

Në këtë kuadër, vlen të theksohet edhe përcaktimet në Rregulloren Evropiane të Burgjeve, ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”¹¹.*

Gjithashtu, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve në Vlorë, nuk ishte pajisur me ambulancë si pjesë e domosdoshme për shërbimin cilësor shëndetësor në kohë të shpejtë për të paraburgosurit në këtë IEVP.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata*

¹⁰Pika 4 të nenit 3, të Ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”

¹¹ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5

publike”; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454, datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” ku parashikohet midis të tjerash se: “2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, Mekanizmi Kombëtar ushtron këto kompetenca:*

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për hidroizolimimin e tarracës të godinës së banimit, për eliminimin e lagështirës në dhomat e të paraburgosurve dhe në ambientet e përbashkëta të dusheve dhe tualeteve.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e ambienteve të veçanta brenda ambienteve të godinës së banimit, për tharjen e rrobave të të paraburgosurve dhe heqjen e menjëhershme për arsye sigurie për jetën e tyre të litarëve, rripave dhe mjeteve të tjera në dhoma, që përdoren për tharjen e rrobave.
3. Marrjen e masave të menjëhershme, për eliminimin e mbipopullimit në IEVP Vlorë, pasi kjo situatë ka sjellë për pasojë shkeljen e të drejtave jetike të personave të paraburgosur që vuajnë dënimin në këtë institucion, si dhe përbën shkelje të standardeve të parashikuara në aktet ligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.
4. Marrjen e masave, për instalimin në godinën e të paraburgosurve të sistemit qendror për ngrohje/ftohjen e ambienteve të brendshme të institucionit, si dhe garantimin në çdo kohë të furnizimit me ujë të ngrohtë për mbajtjen e higjienës personale të të paraburgosurve dhe të ambienteve të përbashkëta, në përshtatje dhe me kushtet klimaterike të zonës.
5. Marrjen e masave të menjëherëshme për furnizimin me ujë të pijshëm 24 orë në ditë në ambientet e Institucionit të IEVP-së Vlorë, dhe deri në realizimin e plotë të investimit të rritet numri i orareve të furnizimit me ujë në 10 orë në ditë nga 6 orë që janë aktualisht.
6. Marrjen e masave të nevojshme për vënien në funksion të ambienteve të pashfrytëzuara, të cilat qendrojnë të mbyllura në institucion.
7. Marrjen e masave për vendosjen e një tende për mbulimin në sektorin e ajrimit në IEVP Vlorë.
8. Marrjen e masave të menjëhershme, për vënien në funksion të të gjitha dusheve, si dhe lyrjen e ambienteve për të qenë sa më të pastra nga ana higjieno-sanitare.

9. Marrjen e masave të menjëhershme, për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualët e sigurisë për këtë kategori.
10. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e Sektorit të Kujdesit të Veçantë (SKV) në IEVP Vlorë.
11. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin sipas strukturës organike të sektorit shëndetësor të institucionit me 1 mjek të dytë të përgjithshëm part time dhe 1 stomatolog, me kohë të plotë me qëllim garantimin cilësor të shërbimit shëndetësor për të burgosurit pacientë kronikë dhe të burgosurit e tjerë.
12. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e plotë dhe furnizimin me medikamente, për rastet e të sëmurëve akutë dhe rastet e emergjencave në IEVP Vlorë.
13. Marrjen e masave të menjëhershme, për përmirësimin e cilësisë së ushqimit dhe larminë e tij sipas produkteve të stinës, si dhe ushtrimin e kontroleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit, për këtë problematikë.
14. Marrjen e masave të menjëhershme, për shtimin e palestrës me materiale, si gira, shtanga sipas peshës dhe vegla të tjera që ndihmojnë të paraburgosurit të kalojnë kohë shlodhëse në këtë drejtim.
15. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për transportin e të sëmurëve në rastet e emergjencave shëndetësore.
16. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen me komodina sipas kushteve normale për jetësë në dhomat e observimit, me kushte higjieno-sanitare të pastra dhe dezinfektim të shpeshtë të këtyre ambienteve në IEVP Vlorë.
17. Marrjen e masave për parashikimin e kapaciteteve të IEVP-së, sipas parashikimeve të standardeve të hapësirës, si dhe të miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me urdhër.
18. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e të paraburgosurve me detergjente dhe materiale të tjera për pastrimin dhe mbajtjen e higjienës personale dhe të ambientit në dhomat e banimit, sipas normativave mujore.
19. Të merren masa të menjëhershme, për shtimin e operatorëve telefonik dhe vënien në punë të aparateve të telefonave që ndodhen në regjimin e brendshëm, për plotësimin e nevojave të të burgosurve për kryerjen e bisedave telefonike me familjarët e tyre, si dhe hapjen e linjës pa shpërblim për numrat e kontaktit me Avokatin e Popullit dhe komunikimin e të burgosurve me institucionin në lidhje me adresimin e ankesave.
20. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për analizimin e mos zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në kompetencë të këtij institucioni, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive për dhënien e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

AHMET PRENÇI